

# Fjalët dhe këpucët



*Nga Ndrek Gjini,  
Irlandë*

Ne morgun ku dergjet trupi i saj i pajete.

## KOHE LUFTE

Shi plumbash po bie perдите.  
Ashti im dhe qielli,  
ne gjak e lot notojne.  
Klithmat kacavirren gjer tek rete.  
E kafkat e shpuara,  
krimbat numerojne.

## FJALET DHE KEPUCET

Fjalet dhe kepucet m'u vjetruan krejt,  
shperfillja dhe balta po i brejne perдите.  
Koha per to s'ka varr as monument.  
Ka vetem cinizem, harrese e frike.

## RETE

Shikimi im i etur per drite  
u mpiks ne altarin e qiellit.  
Rete,  
rete kane pushtuar lartesine,  
Duke e fshehur ne xhep trupin e diellit.

## FUSHA DHE UNE

Dje mbasdite,  
Une dhe livadhi preme floket.  
Ashtu bashke  
Nata na zu jashte.  
Shiu na e beri nje dush  
Pa lejen e henes.

Sot ne mengjes  
Fushen e zgjoi nje puthje e lehte ylberi.  
...Mua, telefonata e nenes.

## SHTEPIA E VJETER

Deren e kthimit e brejti mola.  
Zgavra e saj,  
klithme pritje u be.  
Tani, veç kujtimet,  
keto vizitore te vjeter, sa bota,  
Ketu hyjne e dalin pa bere ze.

## PEIZAZH DHIMBJE

...1997

Male.  
Veç male urretje,  
pa fund e ane.  
E shtigje ankthi,  
qe percjellin te vrare.

Akund s'te rrok syri,  
peme shprese,  
...as bar.  
Veç hije krismash,  
e lot qelibar.

## ANIJA E METAFORAVE

Anijen e metaforave e perpiu Atlantiku.  
Dallget shtrigane ia shqyen velat krejt.

...Tani mua me kane emruar roje

## KOHE E KEQE

Fryn ere qensh.  
Shi krokodili bie pa prà .  
Dielli i dhelpres po ngroh me hile,  
E lulet e zebres s'po dine te çelin.

...Kjo stine kermijsh s'paska te sosur.

## KRQEZIMI I FJALES

E pashe fjalën,  
tek dha shpirt,  
Gozhduar ne kryq  
prej dhunes.

.....  
Perdite lutem,  
per ringjalljen e saj.  
Duke falur goshduesit,  
dhe perqeshjen e turmes.

## LETET NGA BURGU

(Peizazh nga Irlanda)

I dashur mik  
Kete leter per ty  
E shkrova ketu,  
Ne burgun e gjelber.  
Ku fjales mi vjen era bar.  
E endrrat per dite  
Me lagen ne shi.

Ketu, ku jeta dhe vdekja  
Nuk kane kufi.

Ku bari, shiu dhe lulet  
Vdesin e ringjalen brenda dites  
Si me magji.

## TI ERDHE...

Ti erdhe tek une si reja tek rete.  
Me vetetima brengash ne sy.

U ndezem bashke.  
Bashke u shuam  
Te dy.

# Planeti i vjetër



*Nga Albana Lifschin, N. York*

## METROTË E NJU JORKUT

Gojë gjigande,  
na përpijnë çdo mëngjes,  
na vjellin çdo mbrëmje.  
Rit njëqind vjeçar.

Të durueshëm deri në habi  
u besojmë jetën,  
ndërsa, (për çdo rast),  
mbajmë me vete  
qefinin e vdekjes.

## PENTAGRAM

Mbi paralelet e tua  
Edhe dhimbjes më të madhe  
pesë nota i mjaftojnë.  
Për të klithur.  
Lumturisë për t'u dridhur.  
Pentagram, çelsi është i yti  
apo i shpirtit tim?

Janar 21/ 2010

## PLANETI

Në ç'planet të ri më fton miku im,  
kur e di, që s'shkojmë dot kurrkund tjetër,  
ëndrrave krahe u dhamë, por jo adresë,  
tokësore do të kthehen te planet' i vjetër.

2010

## MOS MË DËRGO HESHTJE

Mos më dërgo heshtje  
Heshtja bluan gurë.  
Nuk është për mua.  
në çdo fjalë që dërgon ti  
tek unë merr frymë një poezi

## KOHË MONEDHASH

Në këtë kohë  
monedhash  
zemra erdhi falas.  
Dhe  
pësoi infarkt!

## SHPIRTI I POETES

Mbrëmë një gotë vere  
piva me një poete  
Pashë si shpirtin  
magjishëm hodhi në gotë,  
unë gotat i shkëmbeva  
dhe shpirtin ia mora me vete.

# Rruga Poetët

*Nga Arjan Kallço*

E ka ky qytet një rrugë  
me mbishkrimin Poetët  
paçka e shkurtër dhe e ngushtë,  
si shumë rrugë  
të këtij qyteti të vjetër.  
Kanë ecur në të, të gjithë  
papërgjashim  
me shpirtin plot zjarr  
dhe halle, por  
s'patën nevojë të bëhen mbretër,  
se emrit ia prish ca gërma,  
poetët e kësaj toke  
mbetën (mbr) etër.

## HESHTJE

Heshtin pemët me gjethet zverdhur  
heshtin kodrat, malet tutje me borë  
heshtin rrugët nga gumëzhitjet  
heshtin zemrat nga trokitjet.  
Hesht jeta  
ka ftohtë. Struket dhomave  
plot afsh ngrohtësie.  
U harruan hiret e verës  
festat, plazhet, bukuritë.  
U venitën ëndrrat, dëshirat  
errësira i verboi  
zhurma i shurdhoi.

## SI IKE KËSHTU

Si ike kështu e heshtur  
me mallin peshë ngarkuar  
pa thënë as dhe një fjalë  
si fletët e ditarit të fshehur diku  
tash krejt i harruar.  
Prej vitesh lundron si retë  
lart në qiell e vetmuar,  
sepse e dinë ku kalojnë  
s'do kthehen më  
prandaj lotët e tyre lumojnë.  
Malli yt si det trazuar  
që dallgët tinzare e endën  
kudo  
s'mundi të derdhë asnjë lot  
mbi të, ndryshe  
oqeanet do t'i kishin mbuluar.

## KUR TË KEM NEVOJË

Do t'i kërkoj sytë e tu, e dashur,  
netëve kur hëna kapriçoze,  
për të mos u shfaqur,  
se do fshehë sekrete tradhëtare,  
do na harrojë.  
Kur të kem nevojë për dritë,  
që vargjet lehtas të shkojnë,  
si rrënjët në kërkim të ujit  
drejt të tuve do vrapoj.  
Yjet s'mjaftojnë të ndarë  
janë vetëm një pikë,  
do duhej Aristoteli  
me pasqyrën magjike,  
që pikat t'i kthejë në dritë.